

Buletini i **NFFIS dhe ECO-DRR** për Ballkanin Perëndimor Projekti për Ndërtimin e kapaciteteve për Zvogëlimin e Rreziqeve nga Katastrofat përmes Sistemit Kombëtar të Informimit për Zjarret Pyjore (NFFIS) dhe Eco-DRR Mars 2021 - Shkurt 2026

Projekti për Ndërtimin e Kapaciteteve për Zvogëlimin e Rreziqeve nga Katastrofat përmes Sistemit Kombëtar të Informimit për Zjarret Pyjore (NFFIS) dhe Eco-DRR




Qëllimi i këtij projekti është të fuqizojë kapacitetet e zyrtarëve qeveritarë në parandalimin dhe zbutjen e zjarreve pyjore dhe katastrofave të tjera natyrore përmes krijimit të NFFIS dhe Eco-DRR.

U lansua NFFIS Ver1!

Si Kosova ashtu edhe Mali i Zi kanë zhvilluar me sukses aplikacionet NFFIS dhe ka përfunduar prezantimi dhe pajisjet e Ver. 1.1!!

Fillimisht pritej të përfundonte në gusht, por u përfundua para afatit bazuar në kërkesën e partnerëve në mënyrë që të funksionalizohet sistemi në verë, kur zjarret janë më të shpeshta. U përgatitën manualët e funksionimit dhe mirëmbajtjes, u ofruan trajnime për punonjësit e institucioneve që janë përdorues të sistemit dhe filloi regjistrimi i zjarreve aktuale në korrik dhe gusht.

Në të ardhmen e afërt, NFFIS do të kontribuojë në parandalimin e fatkeqësive dhe zbutjen e zjarreve në të dy vendet.



NFFISver1
(Majtas: Kosova,
Djathtas: Mali I Zi)

Gjendja aktuale e zhvillimit të pyjeve dhe pyllëzimit për parandalimin e ortekeve në Restelice

Në këtë projekt, ne po promovojmë aktivitete për të modeluar pyjet për parandalimin e ortekeve në shpatet e synuara në fshatin Restelice, Kosovë. Në pranverë, Projekti përfundoi punimet ndërtimore (korniza druri dhe gardhe çeliku) për të reduktuar lëvizjen e borës në shpatet që do të dëmtonin pemët e mbjella.

Për më tepër, një studim i rreth 9000 fidanëve të mbjella të Hormoqit dhe Ahut konfirmoi një shkallë mbijetese mbi 90% për të gjitha llojet e drunjëve. Projekti do të mbjellë rreth 20,000 fidanë të reja këtë vjeshtë për të parandaluar më tej orteket në shpatet e synuara.

Në Korrik, kur bora ishte shkrire plotësisht, Projekti ftoi FAO-n, e cila kishte siguruar fidanët pa pagesë, donatorë të tjerë, Ambasadën e Japonisë dhe zyrën e JICA-s në Ballkan për të vizituar vendin e Projektit. Pjesëmarrësit u shprehën se të kuptuarit e tyre për aktivitetet Eco-DRR u thellua dhe poashtu u plotësuan nga të ecurit e cila u mungon si aktivitet i përditshëm



Pyjet bregdetare të Ulqinit



Në Mal të Zi, është paraqitur nevoja për të ruajtur pyjet bregdetare të Ulqinit në pjesën jugore të vendit duke zhvilluar kapacitetet menaxhuese të palëve të interesuara përmes ndërgjegjësimit publik mjedisor dhe mbjelljes së drunjëve. Projekti mbolli drunjë nga nëntori i vitit të kaluar deri në shkurt të këtij viti. Bazuar në një anketë në terren nga ekspertë në Mal të Zi, Projekti përcaktoi vendet dhe metodat e mbjelljes, mbolli rreth 4,000 pisha dhe konfirmoi një shkallë mbijetese prej rreth 80 % që nga korriku. Gjithashtu, në bashkëpunim me brigadat zjarrfikëse vendase është bërë spërkatja me ujë prej makinës zjarrfikëse.



Fidanet e mbjellura
(Pine Halepensis)



Ujitje me kamion të zjarrfikësve



Një video përmbledhse është postuar në kanalin e projektit në youtube me 2022. (Anglisht)

<https://www.youtube.com/watch?v=Z33ZeB8pS0Y>

Mbajtja e seminareve Rajonale

Seminaret rajonale janë mbajtur në Kosovë në dhjetor 2022 dhe në Mal të Zi në mars 2023, me qëllim të raportimit të rezultateve të aktiviteteve dhe ndarjes së përvojave në të dy vendet.

NFFIS, është një aktivitet i përbashkët i të dy vendeve, pjesëmarrësit ndanë ecurinë dhe shkëmbyen informacione dhe opinione mbi sfidat me të cilat përballen, sistemet dhe dokumentet që do të nevojiten për përdorimin e sistemit në të ardhmen.

Dr. Stevko nga CMC (Qendra për Menaxhimin e Krizave) në Maqedoninë e Veriut, menaxher i projektit paraprak, gjithashtu i këshilloi bazuar në përvojat e tij.

Në Kosovë, përderisa ende binte borë, pjesëmarrësit vizituan zonën pyjore për parandalimin e ortekëve për të konfirmuar punët ndërtimore ndihmëse (korniza druri dhe gardhe hekuri) dhe fidanet e mbjellura.

Në Mal të Zi, pjesëmarrësit vizituan pyjet bregdetare dhe konfirmuan gjendjen e fidanëve të mbjella dhe efektet e erërave të forta që vijnë nga bregdeti duke thelluar të kuptuarit e tyre për aktivitetet Eco-DRR.



Përmbledhje e aktiviteteve

Kosova/Mali i Zi –Rezultati 1

Zhvillimi i NFFIS ver1.1

Trajnimi për operimin e NFFIS

Operacionalizimi i NFFIS

Kosovë Rezultati 2

Punë ndihmëse në pyllëzim për parandalimin e ortekut
Përzgjedhja e vendit për aktivitetin e pyjeve për thyerjen e erërave të forta

Mali i Zi Rezultati 2

Mbjellja e rreth 4,000 fidaneve në pyjet bregdetare
Përzgjedhja e vendit për restaurimin e pyjeve pas zjarrit



Ju lutem na ndiqni!

Project Facebook Page
<https://www.facebook.com/WestBalkanNFFISandEcoDRRProject>



Ministry of Internal Affairs (MIA) -
Emergency Management Agency (EMA)



Ministry of Interior (MI) -
Rescue and Protection Directorate (RPD)



Japan International Cooperation Agency (JICA)